LIGJ
Nr. 40/2019

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.6.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11221, datë 11.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË ARABISË, SAUDITE PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Arabisë Saudite, me dëshirën për të nxitur marrëdhëniet e tyre të përbashkëta ekonomike nëpërmjet lidhjes ndërmjet tyre të një Marrëveshjeje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin;
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Personat e përfshirë

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë rezidentë të një ose dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2
Tatimet e përfshira

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, të caktuara në emër të Shteteve Kontraktues ose të nënndarjeve të tyre administrative apo autoriteteve lokale pavarësisht nga mënyra sesi vendosen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat e plota, mbi kapitalin ose mbi elementë të të ardhurave ose kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi fitimin nga tjetërsim i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi totalin e pagave ose pagesat e bëra nga ndërmarrjet, si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje janë veçanërisht:

a) në rastin e Republikës së Shqipërisë:

i. tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e të ardhurave të kapitalit nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme;

ii. tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël; dhe

iii. tatimi mbi pasurinë: (më poshtë quhet "tatimi shqiptar").

b) në rastin e Mbretërisë së Arabisë Saudite:

i. Zakati;

ii. tatimi mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin e investimit në gazin natyror (më poshtë quhet saudit).

4. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen edhe për çdo tatim të njëjtë ose thelbësisht të ngjashëm që vendoset pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të të dy Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të konsiderueshëm që është bërë në ligjet e tyre tatimore.

Neni 3
Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe:

a) termi "Shqipëri" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi të, si dhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë që, në bazë të ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare është në zonën brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi "Mbretëri e Arabisë Saudite" nënkupton territorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite që përfshin gjithashtu zonën jashtë ujërave territoriale ku Mbretëria e Arabisë Saudite ushtron të drejtat e saj sovrane dhe juridiksionale në ujërat e tyre, shtratin detar, nëntokën dhe burimet natyrore në bazë të së drejtës së saj dhe të së drejtës ndërkombëtare;

c) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë, Republikën e Shqipërisë ose Mbretërinë c Arabisë Saudite, sipas kontekstit:

d) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo organizim tjetër personash;

e) termi "shoqëri" nënkupton një person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik, për qëllimet tatimore;

f) termi "ndërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje e drejtuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje e drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi "trafik ndërkombëtar" është çdo transport me anije ose avion i operuar nga një ndërmarrje që ka selinë e menaxhimit efektiv në një Shtet Kontraktues; përveç kur anija ose avioni operojnë vetëm ndërmjet vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;

h) termi "autoritet kompetent" nënkupton;

i. në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Financave ose një përfaqësues të autorizuar të Ministrit të Financave;

ii. në rastin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, Ministrinë e Financave të përfaqësuar nga Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;

i) termi "shtetas" nënkupton:

i. çdo individ që ka kombësinë ose shtetësinë e një Shteti Kontraktues; dhe

ii. çdo person juridik, partneritet ose shoqatë që e fiton statusin e saj si e tillë nga ligjet, në fuqi në një Shtet Kontraktues;

2. Në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar në të, përveç kur përcaktohet shprehimisht ndryshe, ka kuptimin që ai ka në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti për qëllimet e tatimeve për të cilat zbatohet Marrëveshja, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij Shteti mbizotëron mbi kuptimin e dhënë atij termi sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.

Neni 4
Rezidenti

1. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, termi rezident i një Shteti Kontraktues nënkupton çdo person i cili, sipas ligjeve të atij shteti, i nënshtrohet tatimeve atje për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit regjistrimit, vendit të menaxhitimit ose një kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe përfshin edhe atë shtet ose çdo nënndarje administrativi ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimeve në atë Shtet në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë Shtet ose kapitalin që ndodhet në të.

2. Kur për shkak të dispozitës se paragrafit 1, të këtij neni, një individ është rezident në të dy Shtetet Kontraktues, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i një Shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja Shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetike);

b) nëse Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë Shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka vendbanim të zakonshëm;

c) nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja Shtetet Kontraktues ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit nga i cili është shtetas;

d) nëse ai është shtetas i të dy Shteteve Kontraktues ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, një person i ndryshëm nga një individ është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka vendin e menaxhimit efektiv.

Neni 5

Selia e përhershme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi "seli e përhershme" nënkupton një vend të caktuar biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi "seli e përhershme" përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte, dhe

f) çdo vend nxjerrjeje i burimeve natyrore.

3. Termi "seli e përhershme" përfshin gjithashtu:

a) një kantier ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi ose një aktivitet mbikëqyrës në lidhje me një kantier ose projekt por vetëm nëse ky kantier, projekt apo aktivitet vazhdon më shumë se gjashtë muaj;

b) dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim por vetëm nëse aktivitetet e kësaj natyre vazhdojnë (për të njëjtin projekt ose të lidhur me të) brenda një Shteti Kontraktues për një periudhë ose periudha që në total përbëjnë më shume se gjashtë muaj brenda çdo periudhe prej dymbëdhjetë muajsh.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi "seli e përhershme" çmohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi, ose dorëzimin e mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose dorëzimi;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të kryerjes nga ana e ndërmarrjes të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët "a" deri "e" të këtij paragrafi me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6 i këtij neni, vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ajo ndërmarrje konsiderohet të ketë një seli të përhershme në Shtetin e përmendur më parë në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, nëse ky person:

a) ka dhe ushtron rregullisht në atë Shtet autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen tek ato të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni që, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënte këtë vend të caktuar një seli të përhershme sipas dispozitave të këtij paragrafi; ose

b) nuk ka autoritet të tillë, por zakonisht mban në Shtetin e përmendur më parë një sasi mallrash gjendje nga të cilat ai dorëzon rregullisht mallra në emër të ndërmarrjes.

6. Një ndërmarrje nuk çmohet të ketë seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë Shtet nëpërmjet një ndërmjetësi agjent me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në ushtrim të zakonshëm të biznesit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri rezidente të Shtetit tjetër Kontraktues ose që zhvillon biznes në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe) nuk përbën në vetvete që njëra prej këtyre shoqërive është seli e përhershme e tjetrës.

Neni 6
Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që ndodhen në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Termi "pasuri e paluajtshme" ka kuptimin sipas ligjit të Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, ky term përfshin pasurinë aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me pasurinë e paluajtshme, uzufruktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore anijet, varkat dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozita e paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe të ardhurat nga pasuria e paluajtshme që përdoren për kryerjen e shërbimeve të pavarura personale.

Neni 7
Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë Shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër por vetëm për ato që i takojnë asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirrte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe individuale, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme e cilës ajo është në secilin shtet Kontraktues do t'i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme lejohen si zbritje shpenzimet që, janë bërë për qëllime të biznesit të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative, qoftë në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose gjetkë. Megjithatë, asnjë zbritje nuk lejohet në lidhje me shumat e paguara sipas rastit, (ndryshe nga rimbursimi i shpenzimeve faktike) nga selia e përhershme për zyrën kryesore të ndërmarrjes ose një prej zyrave të saj, nëpërmjet tarifave të licencave, tarifave ose pagesave të tjera të ngjashme si shpërblim për

përdorimin e patentave ose të drejtave të tjera, ose nëpërmjet komisionit, për shërbime specifike të kryera ose për menaxhimin ose, përveç rastit të ndërmarrjes bankare, nëpërmjet të ardhurave nga pretendimet e borxhit në lidhje me fondet e dhëna hua selisë së përhershme. Gjithashtu, nuk merret parasysh në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, për shumat e kërkuara (ndryshe nga rimbursimi i shpenzimeve faktike) nga selia e përhershme zyrës kryesore të ndërmarrjes ose një prej zyrave të saj, nëpërmjet tarifave të licencave, tarifave ose pagesave të tjera të ngjashme si shpërblim për përdorimin e patentave ose të drejtave të tjera, ose nëpërmjet komisionit, për shërbime specifike të kryera ose për menaxhimin ose, përveç se në rastin e ndërmarrjes bankare, nëpërmjet interesit për fondet e dhëna hua zyrës kryesore të ndërmarrjes ose një prej zyrave të tjera të saj.

4. Fitimet e biznesit të përftuara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nga eksportimi i mallrave në Shtetin tjetër Kontraktues nuk tatohen në atë Shtet tjetër Kontraktues. Nëse kontratat e eksportit përfshijnë aktivitete të tjera që kryhen nëpërmjet një selie të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues, fitimet e nxjerra nga këto aktivitete mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues.

5. Termi "fitime të biznesit" përfshin por nuk kufizohet tek të ardhurat e përftuara nga prodhimi, tregtimi, aktiviteti bankar, sigurimet nga operacionet e transportit të brendshëm dhe dhënia e shërbimeve. Një term i tillë nuk përfshin kryerjen e shërbimeve personale nga një individ si i punësuar ose në një cilësi të pavarur.

6. Asgjë në këtë nen nuk ndikon në zbatimin e ligjeve të një Shteti Kontraktues në lidhje me tatimet e vendosura mbi të ardhurat që përftohen nga aktivitetet e sigurimeve.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Transporti me anije dhe avion

1. Fitimet nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Termi "fitime të përftuara nga operimi ndërkombëtar i anijeve dhe avionëve përfshin:

a) fitimet e nxjerra nga qiradhënia me bazë të plotë (kohë ose udhëtim) i anijeve ose avionëve të përdorur në transportin ndërkombëtar;

b) fitimet e nxjerra nga qiradhënia pa ekuipazh e anijeve ose avionëve që përdoren në transportin ndërkombëtar;

c) fitimet e nxjerra nga përdorimi ose qiradhënia e kontejnerëve dhe pajisjeve përkatëse të përdorura në transportin ndërkombëtar;

Kjo lidhet në mënyrë të tërthortë me të ardhurat nga operimi ndërkombëtar i anijeve dhe avionëve.

3. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes dërguese është një anije, ai konsiderohet të jetë në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i regjistrimit të anijes, ose nëse nuk ka port regjistrimi, në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është operatori i anijes.

4. Dispozitat e paragrafit l të këtij neni zbatohen dhe për fitimet nga pjesëmarrja në një partneritet, biznes të përbashkët ose agjenci me aktivitet ndërkombëtar.

Neni 9
Ndërmarrjet e asociuara

1. Kur:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe për rrjedhojë të tatohet.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti dhe për rrjedhoje taton fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në atë Shtet tjetër dhe fitimet e përfshira janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së Shtetit të përmendur më parë, nese kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm të sasisë së tatimeve të vendosura në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi duhet t'i kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, sipas rastit, konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues në të cilin është rezidente shoqëria që paguan dividiendët dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të dividendëve. Ky paragraf nuk ndikon në tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

3. Termi "dividendë" siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet, aksionet e "gëzimit" ose të drejta të "gëzimit", aksionet e minierave, aksionet e themeluesve ose të drejta të tjera nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe çdo e ardhur tjetër që i nënshtrohet të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit në të cilin shoqëria që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve që është rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të ci1in shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që ndodhet atje dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efekfivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këto raste, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kur një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shtet tjetër nuk mund të vendosë tatime mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij Shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme ose bazën fikse të vendosur në atë Shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara edhe nëse dividendët e paguar ose

fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë Shtet tjetër.

Neni 11
Të ardhurat nga pretendimet e borxhit

1. Të ardhurat nga pretendimet e borxhit të nxjerra në një Shtet Kontraktues dhe të paguara një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në Shtetin tjetër.

2. Megjithatë këto të ardhura nga pretendimet e borxhit mund të tatohen edhe në shtetin Kontraktues në të cilin zgjidhen edhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i të ardhurave nga pretendimet e borxhit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 10 për qind të shumës bruto të të ardhurave nga pretendimet e borxhit.

3. Termi "të ardhura nga pretendimet e borxhit", siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i garantuar apo jo me hipotekë, pavarësisht nëse mbart të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit. Gjobat për vonesat në pagesa nuk llogariten si të ardhura nga pretendimet e borxhit për qëllimet e këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen, nëse pronari përfitues i të ardhurave nga pretendimet e borxhit që është rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin nxirren të ardhurat nga pretendimet e borxhit, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të, ose kryen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që ndodhet atje dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilin paguhen të ardhurat nga pretendimet e borxhit është efektivisht i lidhur me këtë bazë të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Të ardhurat nga pretendimet e borxhit çmohen të lindin në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i vetë atij shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan të ardhurat nga pretendimet e borxhit, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje më të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën janë paguar të ardhurat nga pretendimet e borxhit dhe këto të ardhura nga pretendimet e borxhit paguhen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë të ardhurat konsiderohen të lindin në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e të ardhurave nga pretendimet e borxhit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12
Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave që nxirren në një shtet kontraktues dhe të paguara një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa licencash mund të tatohen edhe në shtetin kontraktues në të cilin nxirren dhe sipas ligjeve të atij shteti kontraktues por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të këtyre tarifave të licencave që paguhen për përdorimin ose të drejtën për të përdorur pajisjet industriale, tregtare ose shkencore;

b) 8 për qind të shumave bruto të këtyre tarifave të licencave në të gjithë rastet e tjera.

3. Termi "tarifat e licencave", siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejtë autori të veprës letrave, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat kinematografik dhe filmat ose kasetat e përdorura për transmetim në radio ose televizion, çdo patentë, markë tregtare, dizenjo ose model, plan, formulë ose proces sekret, për përdorim të/ose të drejtën për të përdorur pajisjet industriale, tregtare ose shkencore apo për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen, nëse pronari përfitues i tarifave të licencave që është rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin nxirren tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të, ose kryen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që ndodhet atje dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilën paguhen tarifat e licencave lidhet efektivisht me këtë bazë të përhershme ose bazë fikse. Në këto raste, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e tarifave të licencave, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje dhe të ndodhura në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse të disponueshme nga një rezident i një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurisë së luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve që përbëjnë një aksion në një shoqëri që është rezidente e një shteti kontraktues, mund të tatohen në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo sendi pasuror, të ndryshëm nga ai i përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14
Shërbime personale të pavarura

1. Të ardhurat e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose aktivitetet e tjera të një natyre të pavarur, janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç se në rrethanat e mëposhtme kur këto të ardhura mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues:

a) Nëse ai ka një bazë fikse rregullisht të disponueshme prej tij në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të tij, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i përket kësaj baze fikse mund të tatohet në shtetin tjetër kontraktues, ose

b) Nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër kontraktues është për një periudhë ose periudha që janë të barabarta ose kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në të njëjtin vit fiskal përkatës, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që përftohet nga aktivitetet e tij të kryera në shtetin tjetër mund të tatohet në shtetin tjetër kontraktues.

2. Termi "shërbime profesionale" përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose mësimdhënëse, si dhe aktivitet e pavarura të mjekëve, juristëve, inxhinierëve, arkitektëve, densitëve dhe kontabilistëve.

Neni 15
Shërbime personale të varura

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18, 19, 20 dhe 21 të kësaj Marrëveshjeje, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, janë të tatueshëm vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse ushtrohet punësimi, ky shpërblim që përftohet atje mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, është i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse:

a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore e cila fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër , dhe

c) shpërblimi nuk paguhet nga një vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përftuar nga një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që operon në trafikun ndërkombëtar mund të tatohet në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

Neni 16
Tarifat e drejtorëve

Tarifat e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve të një shoqërie e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15 të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues si argëtues, si artist teatri, filmi, radioje ose televizioni ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale të ushtruara si të tilla në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti por nga person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15 të kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

3. Të ardhurat e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga aktivitetet e ushtruara në shtetin tjetër kontraktues siç parashikohet në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përjashtohen nga tatimi në atë shtet tjetër kontraktues nëse vizita në atë shtet tjetër kontraktues mbështetet tërësisht ose kryesisht nga fondet publike të shtetit të parë kontraktues, një nënndarjeje administrative apo autoriteti lokal të tij ose kryhet në bazë të një marrëveshjeje apo mase kulturore ndërmjet shteteve kontraktues.

Neni 18
Pensionet

1. Në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje, pensionet dhe shpërblimet e ngjashme të paguara rezidentit të një shteti kontraktues në lidhje me punësimin e kaluar, tatohen vetëm në atë shtet.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, pensionet e paguara dhe pagesat e tjera të bëra sipas një skeme publike që është pjesë e sistemit të sigurimeve shoqërore të një shtetit kontraktues ose të një nënndarjeje administrative apo autoriteti lokal të tij, tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19
Shërbimet qeveritare

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të paguara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje administrative ose autoritet lokal një individi në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga, ose shpërblime të tjera të ngjashme janë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individi është rezident i atij shteti që:

i. është shtetas i atij shteti, ose

ii. nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues, ose një nënndarje administrative apo autoritet lokal i tij një individi në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension është i tatueshëm vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse individi është rezident dhe shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17, dhe 18 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për rrogat, pagat, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme, në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose nënndarje e tij administrative ose autoritet lokal i tij.

Neni 20
Studentët

1. Pagesat që merr një student ose praktikant biznesi ose stazhier, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në një shtet kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe i pranishëm në shtetin e parë kontraktues vetëm për qëllimin e arsimimit dhe trajnimit të tij, për qëllimin e jetesës, arsimimit ose trajnimit, nuk tatohen në atë shtet me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

2. Pagesat e marra nga studenti, ose praktikanti i biznesit apo stazhieri, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në një shtet kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe i pranishëm në shtetin e parë kontraktues vetëm për arsimimin ose trajnimin e tij dhe që përbën një shpërblim në lidhje me shërbimet e bëra në atë shtet kontraktues tjetër, nuk janë të tatueshme në atë shtet tjetër, me kusht që shërbimet të lidhen me arsimin ose trajnimin dhe të jenë të nevojshme për qëllimet e mbështetjes financiare.

Neni 21
Mësuesit dhe kërkuesit

1. Shpërblimet që merr një mësues ose një kërkues i cili është ose ka qenë rezident në një shtet kontraktues para se të ftohej ose të vizitonte shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e mësimdhënies ose kryerjes së kërkimeve në lidhje më këto aktivitete, nuk tatohen në shtetin tjetër kontraktues për një periudhë që nuk kalon 2 vjet.

2. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për shpërblimin e përftuar nga kërkimi, nëse ky kërkim nuk ndërmerret në interes publik por është kryesisht ose tërësisht për përfitime private të një personi apo personave specifikë.

Neni 22
Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo që lindin, të patrajtuara në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave që është rezident i një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit.

Neni 23
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme e përmendur në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, i zotëruar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe që ndodhet në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme që përbën pjesë të pronës së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose nga pasuria e luajtshme që i përket një baze fikse të disponueshme nga një rezident i një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues, për qëllimin e kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohet në shtetin tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet ose avionët që operojnë të trafikun ndërkombëtar ose nga pasuria e luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve, është i tatueshëm vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjithë elementët e tjerë të kapitalit të një rezidenti të një shteti kontraktues janë të tatueshëm vetëm në atë shtet.

Neni 24

Metodat për eliminimin e tatimit të dyfishtë

Tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

1. Nëse një rezident i një shteti kontraktues nxjerr të ardhura ose zotëron kapital, i cili në pajtim me dispozitata e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohet në shtetin tjetër kontraktues, shteti i përmendur më parë lejon:

a) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat të atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në shtetin tjetër kontraktues;

b) si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në shtetin tjetër kontraktues.

Kjo zbritje, në asnjë rast nuk kalon pjesën e tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin që llogaritet para kryerjes së zbritjes që u takon, sipas rastit të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues.

2. Nëse në pajtim me një dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat e nxjerra nga kapitali në pronësi të një rezidenti të një shteti kontraktues, përjashtohen nga tatimi në atë shtet, ky shtet, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat e mbetura ose kapitalit të këtij rezidenti, nuk mund të marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara ose kapitalin.

3. Në rastin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, metodat për eliminimin e tatimit të dyfishtë nuk cenojnë dispozitat e regjimit të mbledhjes së Zakatit në lidhje me shtetasit Sauditë.

Neni 25

Procedura e Marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person çmon se veprimet e një ose dy shteteve kontraktues rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim, në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident. Çështja mund të paraqitet brenda 3 vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoriteti kompetent, nëse kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që

nuk është në pajtim me Marrëveshjen. Çdo Marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht nga afatet kohore në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktues përpiqen të zgjidhin me anë të Marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ata gjithashtu mund të konsultohen së bashku për shmangien e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktues mund të komunikojnë me njëri-tjetrin për qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

5. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktues, me marrëveshje reciproke, mund të zgjedhin mënyrën e përshtatshme të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht, kërkesat të cilat duhet të përmbushin rezidentët e një shteti kontraktues me qëllim që ta marrin në shtetin tjetër përfitimet dhe përjashtimet tatimore të parashkuara në këtë Marrëveshje.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë atë informacion që është i nevojshëm për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të brendshme të shteteve kontraktuese në lidhje me tatimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje në masën që, tatimi sipas tyre, nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1 i kësaj Marrëveshjeje. Çdo informacion i marrë nga një shtet kontraktues trajtohet si konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe i deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me/ose përcaktimin e ankimeve mbi tatimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në seanca gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësor.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni 2 nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përftueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administratës në të ose shtetin tjetër kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional, proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

3. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues zbaton masat e tij për mbledhjen e informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, megjithëse shtetit tjetër mund të mos i nevojitet ky informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi në përmbajtje të fjalisë së mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 2 të këtij neni por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit thjesht pasi nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

4. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm pasi informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, person i autorizuar ose person që vepron në cilësinë e agjencisë ose dorëzanësit, ose pasi lidhet me interesa pronësie të një personi.

5. Informacioni i marrë sipas këtij neni përdoret vetëm për qëllime tatimore.

Neni 27

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose zyrave konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

Dispozita të ndryshme

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndikon në zbatimin e dispozitave të brendshme për të parandaluar evazionin fiskal dhe shmangien e tatimeve.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Çdo shtet kontraktues njofton tjetrin nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me përfundimin e procedurave që kërkohen nga ligji i tij për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas muajit në të cilin është marrë njoftimi i fundit.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, në lidhje me shumat e paguara në ose pas datës një janar, pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Marrëveshje; dhe

b) në lidhje me tatimet e tjera, për sa u takon viteve tatimore që fillojnë në ose pas datës një janar, pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Marrëveshje.

Neni 30

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar por secili nga shtete kontraktues mund ta përfundojë këtë Marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke i dhënë shtetit tjetër një njoftim me shkrim për përfundimin jo më vonë se data 30 qershor e çdo viti kalendarik që fillon pesë vjet pas vitit në të cilin ka hyrë në fuqi kjo Marrëveshje.

2. Në këtë rast, kjo Marrëveshje pushon së qeni në fuqi:

a) mbi tatimet e mbajtura në burim, në lidhje me shumat e paguara pas fundit të vitit kalendarik në të cilin bëhet një njoftim i tillë; dhe

b) mbi tatimet e tjera, në lidhje me vitet tatimore që fillojnë pas fundit të vitit kalendarik në të cilin bëhet një njoftim i tillë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje, në RIAD, më 6.2.2019 (01.06.1440H) Në gjuhën shqipe, arabe, angleze, ku të gjithë tekstet janë njëlloj autentikë. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	PËR MBRETËRINË E ARABISË SAUDITE
Anila Denaj	**Mohammed A. Al Jadaan**
Ministër i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë	Ministër i Financave i Mbretërisë së Arabisë Saudite

PROTOKOLL

Me nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal në lidhje me Tatimet mbi të Ardhura dhe Kapitalin, Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Arabisë Sauditë kanë rënë dakord që dispozitat e mëposhtme të përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes:

1. Në lidhje me nënparagrafin "d" të paragrafit 1 të nenit 3 të Marrëveshjes:

Kuptohet që termi "person" përfshin gjithashtu shtetin, nënndarjet e tij administrative ose autoritetet lokale.

2. Në lidhje me paragrafin 1 të neni 4 të kësaj Marrëveshjeje:

Kuptohet që termi "rezident i një shteti kontraktues", përfshin:

a) një skemë pensioni të krijuar në atë shtet; dhe

b) një organizatë që është ngritur dhe operon vetëm për qëllime fetare, bamirësie, shkencore, kulturore ose arsimore (ose për më shumë se një prej këtyre qëllimeve) dhe që është rezidentë e atij shteti sipas ligjeve të tij, pavarësisht se e gjitha ose një pjesë e të ardhurave ose fitimeve mund të jenë përjashtuar nga tatimet ose nuk i nënshtrohen tatimit në atë shtet.

3. Në rastin e Shqipërisë, termi "evazion tatimor" do të thotë "evazion fiskal" brenda përmbajtjes së Marrëveshjes.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në dy kopje, në RIAD, më 6.2.2019 (01.06.1440H) Në gjuhën shqipe, arabe, angleze, ku të gjithë tekstet janë njëlloj autentikë. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	PËR MBRETËRINË E ARABISË SAUDITE
Anila Denaj	**Mohamed A. Al Jadaan**
Ministër i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë	Ministër i Financave i Mbretërisë së Arabisë Saudite